

Prokurimi publik në Kosovë dhe fuqizimi ekonomik gjithëpërfshirës



Prokurimi publik në Kosovë
dhe fuqizimi ekonomik
gjithëpërfshirës

Dhjetor 2023

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është përgatitur me kërkesë të UNDP-së, përmes projektit Mbështetje në Përpjekjet Kundër-Korrupsionit në Kosovë (SAEK) III, me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe Agjencisë Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA), për të promovuar transparencën institucionale dhe buxhetore dhe llogaridhënien. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e UNDP-së në Kosovë, SDC dhe SIDA.

— Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
1. Sistemi i prokurimit në Kosovë dhe përgjegjshmëria gjinore	4
2. Kush ka përfituar nga prokurimi publik në vitin 2022?	6
2.1. Prokurimi publik në nivelin qendror	7
2.2. Prokurimi publik në nivelin lokal të qeverisjes	8
2.3. Prokurimi publik në institucionet e pavarura	10
2.4. Prokurimi publik në ndërmarrjet publike	11
3. Përfundime dhe rekomandime	13
Shtojcat	14

Mbështetur nga:

Përmbledhje ekzekutive

Prokurimi publik është i hapur për të gjithë operatorët ekonomikë të cilët ofrojnë mallra dhe shërbime, por, që nuk përfitojnë të gjithë njësoj. Të dhënat zyrtare për vitin 2022 tregojnë se në Kosovë, prokurimi publik përbënte 6.5% të Bruto Produktit Vendor (BPV). Procedurat e prokurimit publik rregullohen me Ligjin për prokurim publik, mirëpo ky ligj nuk përmban perspektivë gjinore dhe nuk përkon me Ligjin për barazi gjinore. Pavarësisht praktikave ndërkombëtare për fuqizimin ekonomik të grave dhe avancimin e barazisë gjinore, gratë mbeten të nënpërfaqësuar në fushën e prokurimit publik në Kosovë.

Për zvogëlimin e hendekut gjinor në prokurim publik ka mundësi të vendosjes së masave të veçanta, siç mund të jetë analiza gjinore e prokurimit e cila bazohet në vlerësim të nevojave, përcaktimi i objektivave të arritjes së barazisë gjinore për të siguruar përfshirjen e ofertueseve gra, si dhe masat afirmative që parashihen me Ligjin për barazi gjinore. Të gjitha këto praktika janë faktorë përbërës të prokurimit të përgjegjshëm gjinor. Prokurimi i përgjegjshëm gjinor shihet si një mjet për të promovuar fuqizimin dhe përfshirjen ekonomike të grave, duke kontribuar gjithashtu në arritjen e treguesve 5 dhe 8 të Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Për më tepër, kjo është një praktikë e promovuar edhe nga Banka Botërore, Bashkëpunimi Ndërkombëtar Financiar, direktivat e Bashkimit Evropian dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik midis subjekteve të tjera ndërkombëtare.

Për të parë shtrirjen e prokurimit të përgjegjshëm gjinor në Kosovë, Instituti GAP ka analizuar gjithsej 9,673 kontrata të prokurimit publik në vitin 2022. Nga këto të fundit, 81.1% operatorë ekonomikë përfitues janë në pronësi të burrave, 10.3% janë operatorë ekonomikë përfitues në pronësi të grave, 5.8% janë operatorë ekonomikë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje, dhe për 2.7% të operatorëve ekonomik përfitues gjinia e pronarëve/eve është e panjohur. Operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 405 milionë euro apo 78.7% të gjithsej kontratave të prokurimit publik gjatë vitit 2022, kurse ato në pronësi të grave kanë përfituar 25.4 milionë euro apo 4.9%.

Duke parë hendekun gjinor, Instituti GAP rekomandon të integrohet pikëpamja gjinore përgjatë gjithë procesit të prokurimit publik, përkritazi me kornizën ligjore të Kosovës, si dhe praktikat ndërkombëtare të prokurimit të përgjegjshëm gjinor.

1. Sistemi i prokurimit në Kosovë dhe përgjegjshmëria gjinore

Prokurimi publik është mjet i menaxhimit të financave publike i cili përfshin blerjen e mallrave dhe shërbimeve nga autoritetet publike.¹ Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE), prokurimi publik përfshinte 12.6% të Bruto Produktit Vendor (BPV) botëror në vitin 2019.² Përderisa prokurimi publik është i hapur për të gjithë ata që dëshirojnë të ofertojnë, operatorët ekonomikë jo domosdoshmërisht përfitojnë njësoj.

Në Kosovë, prokurimi publik ishte vlerësuar si 6.5% e BPV-së në vitin 2022.³ Procedurat e prokurimit publik në Kosovë rregullohen me Ligjin për prokurimin publik (Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-068) dhe legjislationin në varësi të tij. Përderisa sistemi i prokurimit në Kosovë ka pasur progres të dukshëm, sidomos në lidhje me prokurimin elektronik përmes platformës e-Prokurimi, ky sistem akoma ka mangësi e sfida të ndryshme.⁴ Kontratat jepen kryesisht në bazë të kriterit të çmimit më të ulët, duke mos marrë parasysh kriteret e cilësisë apo ndikimin social të këtyre kontratave, duke përfshirë këtu edhe ndikimin në barazi gjinore.⁵

Prokurimi i përgjegjshëm gjinor i referohet integritit të pikëpamjes gjinore në procesin e prokurimit.⁶ Kjo qasje synon të adresojë pabarazitë gjinore, të promovojë fuqizimin e ekonomik të grave, si dhe të krijojë rezultate gjithëpërfshirëse dhe të paanshme të prokurimit në sektorin publik dhe privat. Ligji për barazi gjinore në Kosovë i obligon të gjitha institucionet publike që të marrin masa të përkohshme të veçanta për të përsheptuar realizimin e barazisë aktuale ndërmjet grave dhe burrave në fushat ku ekzistojnë pabarazi.⁷ Sipas këtij ligji, për shembull, ministrinë dhe komunat, si autoritete kontraktuese, mund të përdorin veprime afirmative për të inkurajuar bizneset në pronësi të grave dhe/ose kompanitë me më shumë punonjëse gra që të aplikojnë.⁸ Megjithatë, kjo nuk përkon me realitetin e prokurimit publik në Kosovë, ku bizneset në pronësi të grave janë të nënpërfaqësuar.

Përveç nënpërfaqësimit të bizneseve të grave në prokurim publik, Ligji për prokurim publik në Kosovë nuk siguron gjithëpërfshirje dhe mosdiskriminim. Ky ligj nuk përmban përfshirje gjinore përkitazi me Ligjin për barazi gjinore; konkretisht duke u bazuar në nenin 4, paragrafi 5 që thotë "përemri 'ai' dhe mbiemri 'i tij' vlejnë në mënyrë të barabartë për secilën gjini dhe po ashtu i referohen një ndërmarrje aty ku kjo kërkohet nga konteksti".⁹

Organizatave buxhetore mund të sigurojnë që gratë dhe burrat të përfitojnë nga vendet e punës të krijuara nga projektet e financuara nga fondet publike. Kjo mund të arrihet përmes masave dhe politikave të ndryshme, si: analiza gjinore e prokurimit e bazuar në një analizë të nevojave, specifikimet gjinore në mënyrë që të mos përjashtohen ofertueset gra, përzgjedhja e përfituesve/eve duke zbatuar masat afirmative të parapara me Ligjin për barazi gjinore (shembull: shënimi i më shumë pikëve për bizneset në pronësi të grave apo atyre që kanë të punësuarat më së shumti gra), dhe kontratat e ndjeshme gjinore.

1 Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. [Prokurimi publik](#).

2 Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. [Madhësia e prokurimit publik](#), 2021.

3 Zyra Kombëtare e Auditimit. [Raport i auditimit të teknologjisë së informacionit: Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi](#), 2023.

4 Qeveria e Kosovës. [Programi i Reformës Ekonomike 2023-25](#), 2023.

5 Po, aty.

6 Instituti Evropian për Barazi Gjinore (EIGE). [Prokurimi i përgjegjshëm gjinor](#), 2021.

7 Ligji [Nr. 05/L-020](#) për barazi gjinore, neni 6.

8 Po, aty.

9 Ligji [Nr. 04/L-042](#) për prokurimin publik në Republikën e Kosovës, neni 4, paragrafi 5.

Disa shtete në zhvillim kanë përfshirë specifika në lidhje me bizneset në pronësi të grave në kriteret e vlerësimit për blerjet nën një shumë të caktuar; pra, ekzistojnë mekanizma të cilat përfshijnë programe të çertifikimit të bizneseve në pronësi të grave, trajnime dhe politika preferenciale në proceset e ofertimit.¹⁰ Disa nga këto praktika mund të merren parasysh edhe nga shtetet e tjera në zhvillim të cilat synojnë të mbështesin fuqizimin ekonomik të grave.

Prokurimi i përgjegjshëm gjinor shihet si një mjet për të promovuar fuqizimin dhe përfshirjen ekonomike të grave, duke kontribuar gjithashtu në arritjen e treguesëve 5 dhe 8 të Qëllimeve për Zhvillim të Qëndrueshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.^{11,12} Për më tepër, kjo është një praktikë e promovuar edhe nga Banka Botërore (BB),¹³ Bashkëpunimi Ndërkombëtar Financiar (BNF),¹⁴ direktivat e Bashkimit Evropian (BE)¹⁵ dhe Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OBZHE).¹⁶

Duke marrë parasysh rëndësinë e prokurimit të përgjegjshëm gjinor si mjet për menaxhimin e financave publike, Instituti GAP ka analizuar përfituesit/et e kontratave publike për vitin 2022 për të identifikuar pjesëmarrjen e bizneseve në pronësi të grave në prokurimin publik. Sipas raportit vjetor të Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik (KRPP),¹⁷ dhe raportit të auditimit të teknologjisë së informacionit nga Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA),¹⁸ numri gjithsej i kontratave të prokurimit publik gjatë vitit 2022 është 10,290 me vlerë gjithsej 559 milionë euro. Mirëpo, këto të dhëna nuk përkohet me të dhënat publike nga KRPP, sipas të cilave në vitin 2022 janë nënshkruar 9,673 kontrata të prokurimit publik me vlerë 514 milionë euro.¹⁹ Andaj, për këtë raport Insituti GAP ka analizuar të dhënat publike, pra 9,673 kontrata me vlerë 514.5 milionë euro.

Mungesa e të dhënave të ndara sipas gjinisë vazhdon të jetë problem pasi KRPP nuk e bën këtë ndarje. Si pasojë, Instituti GAP ka ndarë çdo operator ekonomik veçmas për të evidentuar gjininë e pronarëve/eve përfitues/e duke u bazuar në platformën interaktive të Agjencisë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK). Përveç ndarjes sipas gjinisë së pronarëve/eve të operatorëve ekonomikë përfitues, Instituti GAP ka analizuar vlerat e kontratave, dhe ka ndarë këto të dhëna sipas autoriteteve kontraktuese në nivelin qendror dhe atë lokal të qeverisjes.

10 Disa nga këto shtete në zhvillim përfshijnë shtetet e Amerikës Latine si: Republika Domenikane, Kili, dhe Kolumbia. ILDA, [Përfshirja e grave në prokurimet publike: Përvoja e Amerikës Latine](#), 2020.

11 Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat.

12 Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, punësimi i plotë dhe produktiv dhe puna e denjë për të gjithë.

13 Banka Botërore. [Draft Strategjia gjinore e Grupit të Bankës Botërore \(FY16-23\)](#); barazia gjinore, reduktimi i varfërisë dhe rritja gjithëpërfshirëse, 2023.

14 Bashkëpunimi Ndërkombëtar Financiar. [Barazia gjinore dhe përfshirja ekonomike](#). Qasur së fundi në shtator 2023.

15 Bashkimi Evropian. [Strategjia për Barazi Gjinore 2020-2025](#).

16 Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik. [Promovimi i barazisë gjinore përmes prokurimit](#), 2022.

17 Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik. [Raporti vjetor 2022](#), 2023.

18 Zyra Kombëtare e Auditimit. [Raport i Auditimit të Teknologjisë së Informacionit: Sistemi elektronik i prokurimit publik e-prokurimi](#), 2023.

19 [Komisioni Rregullativ për Prokurimin Publik.\(KRPP\)](#)

2. Kush ka përfituar nga prokurimi publik në vitin 2022?

Nga 9,673 kontrata të prokurimit publik gjatë vitit 2022, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 7,850 apo 81.1% të kontratave; operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar 996 apo 10.3% të kontratave; operatorët ekonomikë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfituar 562 apo 5.8% të kontratave; dhe për 262 apo 2.7% të kontratave, gjinia e pronarëve/eve përfitues/e mbetet e panjohur. Gjatë vitit 2022, nga gjithsej 514.5 milionë euro, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 405 milionë euro apo 78.7%, ato në pronësi të grave kanë përfituar 25.4 milionë euro apo 4.9%, ato në bashkëpronësinë e të paktën një gruaje 61.8 milionë euro apo 12% dhe operatorët pronësia e të cilëve mbetet e panjohur kanë përfituar 22.3 milionë euro apo 4.3%. Vlera mesatare e kontratave për operatorët ekonomikë në pronësi të burrave është 51,521 euro, për operatorët ekonomikë në pronësi të grave është 25,696 euro, për operatorët ekonomikë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje është 110,571 euro, kurse për operatorët ekonomikë ku gjinia e pronarëve/eve mbetet e panjohur është 82,730 euro.

Figura 1. Numri i kontratave të prokurimit publik në vitin 2022, sipas gjinisë




Figura 2. Vlera e kontratave të prokurimit publik në vitin 2022, sipas gjinisë



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Instituti GAP ka analizuar përfituesit/et sipas autoriteteve kontraktuese të nivelit qendror, lokal, institucionet e pavarura dhe ndërmarrjet publike. Operatorët ekonomikë me ndarjen më të madhe të buxhetit përmes prokurimit publik janë ata të nivelit lokal (komunat) me 3,721 kontrata të nënshkruara gjatë vitit 2022, me vlerë gjithsej 230.8 milionë euro.

Figura 3. Vlera dhe numri i kontratave të prokurimit publik në nivelin qendror, lokal, institucionet e pavarura, ndërmarrje publike, sipas gjinisë së pronarëve/eve




Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

2.1. Prokurimi publik në nivelin qendror

Sipas numrit të kontratave, nga gjithsej 2,950 kontrata të nënshkuara nga autoritetet kontraktuese të nivelit qendror, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 2,379 apo 81% të kontratave, operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar 250 apo 8% të kontratave, operatorët ekonomikë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfituar 255 apo 9% të kontratave, dhe për 66 apo 2% të kontratave, gjinia e pronarëve/eve përfitues/e mbetet e panjohur. Hendeku më i madh gjinor në numrin e kontratave të ndara nga këto institucione është më i pranishëm tek Ministria për Komunitete dhe Kthim, ku 92% kontratave janë përfituar nga operatorë ekonomikë në pronësi të burrave dhe vetëm 8% në pronësi të grave (Shtojca 1). Ndërsa hendeku gjinor në numrin e kontratave është më pak i pranishëm tek Minsitria e Zhvillimit Rajonal, ku 55% e kontratave janë përfituar nga operatorë ekonomikë në pronësi të burrave dhe 35% në pronësi të grave.


Figura 4. Numri i kontratave të nënshkuara nga institucionet e nivelit qendror të qeverisjes, të ndara sipas gjinisë së përfituesve/eve



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Sipas vlerës së kontratave, nga 179.8 milionë euro të ndara nga ministrinë e linjës, Zyra e Kryeministrit, Zyra e Presidentes dhe Kuvendi i Kosovës, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfitur rreth 142.5 milionë euro apo 79% të vlerës, operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfitur rreth 6.3 milionë euro apo 4% të vlerës, ato në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfitur rreth 26.5 milionë euro apo 15% të vlerës, kurse ata pronësia e të cilëve mbetet e panjohur kanë përfitur rreth 4.4 milionë euro apo 2% të vlerës. Hendeku më i madh gjinor për sa i përket shumës së vlerave të kontratave të nënshkuara është më i pranishëm tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ku operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfitur 95% të shumës së kontratave të prokurimit publik nga ky institucion në krahasim me 0.2% të operatorëve ekonomikë përfitues në pronësi të grave (Shtojca 2). Ndërsa hendeku gjinor më i vogël për sa i përket shumës së vlerave të kontratave është i pranishëm tek Ministria e Zhvillimit Rajonal, ku 58% e operatorëve ekonomikë përfitues janë në pronësi të burrave dhe 36% e operatorëve ekonomikë përfitues janë në pronësi të grave.²⁰

Figura 5. Operatorët ekonomikë të nivelit qendror me vlerën më të madhe (në euro) të ndarë përmes prokurimit publik




Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

2.2. Prokurimi publik në nivelin lokal të qeverisjes

Ngjashëm si në nivelin qendror, edhe në nivelin lokal, operatorët ekonomikë përfitues në pronësi të grave mbeten të nënpërfaqësuar në numrin e kontratave publike. Nga gjithsej 3,721 kontrata të nënshkuara në 2022 nga niveli lokal, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfitur 3,088 apo 83% të kontratave, operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfitur 331 apo 9% të kontratave, operatorët ekonomikë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfitur 182 apo 5% të kontratave, dhe për 120 apo 3% të kontratave, gjinia e pronarëve/eve përfitues/e mbetet e panjohur. Hendeku gjinor në numrin e kontratave të ndara është më i pranishëm tek Komuna e Parteshit, ku 100% e përfituesve të kontratave janë operatorë ekonomikë në pronësi të burrave (Shtojca 3). Ndërsa hendeku gjinor në numrin e kontratave të ndara është më i vogël në Komunën e Mitrovicës së Veriut, ku 62% e përfituesve të kontratave janë operatorë ekonomikë në pronësi të burrave dhe 19% janë në pronësi të grave.

²⁰ Operatorët ekonomikë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfitur 73% të shumës së vlerave të kontratave.


Figura 6. Numri i kontratave të nënshkruara nga institucionet e nivelit lokal, të ndara sipas gjinisë së përfituesve/eve



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Sipas vlerës së kontratave, shumica më e madhe e kontratave të prokurimit publik në nivelin lokal 34.3 milionë euro (14.8%) është nënshkruar nga Komuna e Prishtinës, kurse shumica më e vogël 5,895 euro (0.002%) është nënshkruar nga Komuna e Parteshit. Nga 3,721 kontrata publike nga komunat e Kosovës, operatorë ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar rreth 182.2 milionë euro apo 79%, operatorë ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar rreth 12.1 milionë euro apo 5%, ato në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfituar rreth 30.7 milionë euro apo 13%, kurse ato pronësitë e të cilëve mbetet e panjohur kanë përfituar rreth 5.7 milionë euro apo 2%. Hendeku më i madh gjinor për sa i përket shumës së vlerave të kontratave të nënshkruara është më i pranishëm tek Komuna e Parteshit, ku operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 100% të vlerës së kontratave të prokurimit publik (Shtojca 4). Ndërsa hendeku gjinor më i vogël për sa i përket shumës së vlerave të kontratave është i pranishëm tek Komuna e Vitisë, ku 49% e operatorëve ekonomikë përfitues janë në pronësi të burrave dhe 38% e operatorëve ekonomikë përfitues janë në pronësi të grave.

Figura 7. Operatorët ekonomikë të nivelit lokal me vlerën më të madhe (në euro) të ndarë përmes prokurimit publik



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

2.3. Prokurimi publik në institucionet e pavarura

Nga gjithsej 355 kontrata të nënshkruara nga institucionet e pavarura, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 281 apo 79% të kontratave, operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar 33 apo 9% të kontratave, operatorët ekonomikë në pronësi të të paktën një gruaje kanë përfituar 31 apo 9% të kontratave, dhe për 10 apo 3% të kontratave, gjinia e pronarëve/eve përfitues/e mbetet e panjohur. Hendeku gjinor në numrin e kontratave të ndara është më i pranishëm tek Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), ku 100% e operatorëve ekonomikë përfitues të kontratave janë në pronësi të burrave (Shtojca 5). Ndërsa hendeku gjinor në numrin e kontratave të ndara është më i vogël tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ku 62% operatorëve ekonomikë përfitues të kontratave janë në pronësi të burrave dhe 19% janë në pronësi të grave.


Figura 8. Numri i përfituesve/eve të prokurimit publik në institucionet e pavarura, sipas gjinisë



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Sipas vlerës së kontratave të ndara nga institucionet e pavarura, shumica më e madhe e kontratave prej 4.2 milionë euro (42%) është nënshkruar nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale, kurse shumica më e vogël prej 3,864 euro (0.03%) është nënshkruar nga Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë. Nga 281 kontrata publike të nënshkruara nga institucionet e pavarura, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar rreth 7 milionë euro apo 78%, operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar rreth 1.2 milionë euro apo 14%, ata në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfituar 621,899 euro apo 7%, kurse ata operatorë ekonomikë pronësia e të cilëve mbetet e panjohur kanë përfituar 125,216 euro apo 3%. Hendeku më i madh gjinor për sa i përket shumës së vlerave të kontratave të nënshkruara është më i pranishëm tek Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, ku operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 100% të vlerës së kontratave të prokurimit publik (Shtojca 6). Ndërsa hendeku gjinor më i vogël për sa i përket shumës së vlerave të kontratave është i pranishëm tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, ku 48% e operatorëve ekonomikë përfitues janë në pronësi të burrave dhe 46% janë në pronësi të grave.

Figura 9. Operatorët ekonomikë nga institucionet e pavarura me vlerën më të madhe (në euro) të ndarë përmes prokurimit publik



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

2.4. Prokurimi publik në ndërmarrjet publike

Sipas numrit të kontratave të nënshkruara nga ndërmarrjet publike, nga gjithsej 2,647 kontrata, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 2,102 apo 79% të kontratave, operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar 382 apo 14% të kontratave, operatorët ekonomikë në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfituar 94 apo 4% të kontratave, dhe për 69 apo 3% të kontratave, gjinia e pronarëve/eve përfitues/e mbetet e panjohur. Hendeku gjinor në numrin e kontratave të ndara është më i pranishëm tek Sportmarketing, K.R.U. "Drini i Bardhë", dhe Stacioni i Autobusëve Gjakovë, ku në të tri rastet, operatorë ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 100% të kontratave të prokurimit publik. Kurse hendeku më i vogël gjinor është i pranishëm tek Trepça dhe Qendra Multifunkionale, ku në dy rastet 67% e përfituesve janë operatorë ekonomikë në pronësi të burrave dhe 33% janë operatorë ekonomikë në pronësi të grave (Shtojca 7).


Figura 10. Numri i përfituesve/eve të prokurimit publik në ndërmarrjet publike, sipas gjinisë



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Sipas vlerës së kontratave të ndara nga ndërmarrjet publike, shuma më e madhe e kontratave të prokurimit publik prej 45.5 milionë euro (48%) është nënshkruar nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), kurse shuma më e vogël prej 3,951 euro (0.004%) është nënshkruar nga K.R.U. "Drini i Bardhë". Nga 2,647 kontrata publike të nënshkruara nga ndërmarrjet publike, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar rreth 73.2 milionë euro apo 77%, operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar rreth 5.7 milionë euro apo 6%, ata në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfituar rreth 3.7 milionë euro apo 4%, kurse ata pronësia e të cilëve mbetet e panjohur kanë përfituar rreth 12 milionë euro apo 13%. Hendeku më i madh gjinor për sa i përket shumës së vlerave të kontratave të nënshkruara është më i pranishëm tek Stacioni i Autobusëve Gjakovë dhe K.R.U. " Drini i Bardhë", ku operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 100% të vlerës së kontratave të prokurimit publik. Ndërsa hendeku më i vogël gjinor është i pranishëm tek Trepça, ku operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 61% të shumës së kontratave nga kjo ndërmarrje dhe operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar 28% të shumës së kontratave nga kjo ndërmarrje (Shtojca 8).

Figura 11. Operatorët ekonomikë nga ndërmarrjet publike me vlerën më të madhe (në euro) të ndarë përmes prokurimit publik



Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

3. Përfundime dhe rekomandime

Analiza e kontratave publike gjatë vitit 2022 tregon se bizneset e grave mbeten të nënpërfaqësuar në fushën e prokurimit publik në Kosovë. Ndonëse Ligji për barazi gjinore obligon të gjitha institucionet publike përfshirë ministritë, komunat dhe çdo autoritet tjetër kontraktues të përfshijë pikëpamjen gjinore në veprimtarinë e tyre, zbatimi i këtij ligji stagnon në procedurat e prokurimit publik.

Operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 81.1% të kontratave në proceset e prokurimit për vitin 2022, operatorët ekonomikë në pronësi të grave kanë përfituar 10.3% të kontratave, ata në bashkëpronësi të të paktën një gruaje kanë përfituar 5.8% të kontratave, dhe për 2.7% të operatorëve ekonomikë përfitues gjinia e pronarëve/eve është e panjohur. Operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 405 milionë euro apo 78.7% të gjithsej kontratave të prokurimit publik gjatë vitit 2022, kurse ato në pronësi të grave kanë përfituar 25.4 milionë euro apo 4.9%.

Hendeku gjinor në prokurim është dukshëm i pranishëm tek institucionet e nivelit qendror dhe lokal. Në nivelin qendror të qeverisjes, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar 79% të vlerës së kontratave në krahasim me operatorët ekonomikë në pronësi të grave të cilat kanë përfituar vetëm 4% të vlerës së kontratave. Ngjashëm, edhe në nivelin lokal të qeverisjes, operatorët ekonomikë në pronësi të burrave kanë përfituar rreth 79% të vlerës së kontratave në krahasim me operatorët ekonomikë në pronësi të grave të cilat kanë përfituar 5% të kontratave.

Duke u bazuar në gjetjet e kësaj analize, Instituti GAP rekomandon:

- Të integrohen kritere dhe specifikime të ndjeshme gjinore në proceset e prokurimit publik. Kjo mund të përfshijë vlerësimin e ofertuesve bazuar në angazhimin e tyre për barazinë gjinore, si p.sh. politika për fuqizimin e grave, trajtimi i drejtë i punonjëseve gra dhe ofrimi i mundësive për bizneset në pronësi të grave. Kjo qasje siguron që aspekti gjinor të përfshihet në vlerësimin e ofertave.
- Të caktohen objektiva dhe/ose kuota për pjesëmarrjen e bizneseve në pronësi të grave në proceset e prokurimit përkitazi me Ligjin për barazi gjinore, saktësisht neni 6, masat e veçanta²¹.
- Të bëhet mbledhja sistematike e të dhënave të ndara sipas gjinisë për të gjurmuar pjesëmarrjen e bizneseve në pronësi të grave, punonjëseve gra brenda organizatave ofertuese dhe ndikimin e vendimeve të prokurimit në barazinë gjinore. Këto të dhëna do të ndihmojnë në identifikimin e hendeqeve dhe monitorimin e progresit, duke lehtësuar politikëbërjen.

²¹ [Ligji Nr. 05/L-019 për Barazi Gjinore](#), neni 6, paragrafi 1 "Institucionet publike marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimin të realizimit të barazisë faktike midis femrave dhe meshkujve në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi.", dhe paragrafi 7 "Organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore në të gjitha nivelet, si dhe institucionet tjera publike, janë të obliguara të miratojnë dhe zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve sipas këtij ligji".

Shtojcat

Shtojca 1. Numri i përfituesve/eve të prokurimit publik në nivelin qendror, sipas organizatës buxhetore dhe gjinisë së pronarëve/eve

Autoriteti Kontraktues	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	
Ministria e Shëndetësisë	1,021	84%	63	5%	121	10%	9	1%	1214
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	281	79%	37	10%	24	7%	14	4%	356
Ministria e Punëve të Brendshme	253	80%	31	10%	19	6%	13	4%	316
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	229	80%	27	9%	19	7%	12	4%	287
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	92	75%	13	11%	14	11%	3	2%	122
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	45	80%	8	14%	2	4%	1	2%	56
Ministria e Mbrojtjes	78	87%	3	3%	8	9%	1	1%	90
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	66	73%	11	12%	10	11%	3	3%	90
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	49	72%	13	19%	5	7%	1	1%	68
Ministria e Drejtësisë	42	70%	9	15%	8	13%	1	2%	60
Zyra e Kryeministrit	99	83%	6	5%	8	7%	6	5%	119
Zyra e Presidentes	28	72%	8	21%	2	5%	1	3%	39
Kuvendi i Republikës së Kosovës	22	71%	5	16%	4	13%			31
Ministria e Punëve të Jashtme	18	64%	5	18%	4	14%	1	4%	28
Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal	16	76%	2	10%	3	14%			21
Ministria e Zhvillimit Rajonal	11	55%	7	35%	2	10%			20
Ministria e Ekonomisë	17	85%	1	5%	2	10%			20
Ministria për Komunitete dhe Kthim	12	92%	1	8%					13
Gjithsej	2,379	81%	250	8%	255	9%	66	2%	2,950

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Shtojca 2. Vlera e kontratave të prokurimit publik në nivelin qendror, sipas autoritetit kontraktues dhe gjinisë së pronarëve/eve

Autoriteti Kontraktues	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	Vlera (€)
Ministria e Shëndetësisë	46,447,898	66%	3,050,338	4%	19,507,738	28%	1,195,258	2%	70,201,232
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	30,789,120	95%	84,013	0%	955,230	3%	673,553	2%	32,501,918
Ministria e Punëve të Brendshme	23,059,130	84%	1,319,162	5%	2,307,957	8%	654,571	2%	27,340,820
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	12,976,262	88%	645,332	4%	816,152	6%	232,752	2%	14,670,499
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	9,308,832	76%	812,808	7%	960,475	8%	1,236,555	10%	12,318,671
Ministria e Mbrojtjes	7,733,905	84%	12,941	0%	1,462,698	16%	29,740	0%	9,239,284
Ministria e Drejtësisë	4,950,743	94%	114,624	2%	143,811	3%	50,526	1%	5,259,704
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	2,149,922	95%	27,950	1%	23,944	1%	72,492	3%	2,274,308
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	2,020,464	91%	37,167	2%	147,040	7%	6,155	0%	2,210,827
Zyra e Kryeministrit	1,125,887	89%	58,952	5%	68,339	5%	15,531	1%	1,268,711
Zyra e Presidentes	227,634	73%	56,800	18%	22,410	7%	4,307	1%	311,153
Kuvendi i Republikës së Kosovës	46,372	17%	26,479	10%			202,885	74%	275,736
Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë	594,531	79%	26,303	4%	128,748	17%	750	0%	750,333
Ministria e Ekonomisë	597,817	89%	48,380	7%	21,881	3%			668,079
Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal	61,859	90%	3,832	6%	3,332	5%			69,025
Ministria e Punëve të Jashtme	177,706	91%	6,848	4%	9,165	5%	936	0%	194,657
Ministria për Komunitete dhe Kthim	253,138	98%	5,350	2%					258,488
Ministria e Zhvillimit Rajonal	39,241	58%	24,382	36%	4,331	6%			67,954
Gjithsej	142,560,461	79%	6,361,661	4%	26,583,251	15%	4,376,011	2%	179,881,399

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Shtojca 3. Numri i përfituesve/eve të prokurimit publik në nivelin lokal, sipas organizatës buxhetore dhe gjinisë së pronarëve/eve

	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	
Komunat									
Prishtinë	250	86%	20	7%	18	6%	6	2%	292
Prizren	211	86%	15	6%	14	6%	4	2%	244
Dragash	164	93%	4	2%	6	3%	2	1%	176
Suharekë	159	93%	5	3%	2	1%	5	3%	171
Vushtrri	156	90%	9	5%	4	2%	5	3%	174
Malishevë	146	86%	10	6%	6	4%	7	4%	169
Podujevë	142	86%	17	10%	5	3%	2	1%	166
Lipjan	127	82%	11	7%	6	4%	10	6%	154
Istog	113	85%	12	9%	4	3%	4	3%	133
Gjakovë	110	75%	23	16%	4	3%	9	6%	146
Shtime	100	87%	7	6%	5	4%	3	3%	115
Mitrovicë e Jugut	95	87%	7	6%	7	6%	/	/	109
Ferizaj	91	77%	5	4%	11	9%	11	9%	118
Pejë	89	82%	8	7%	10	9%	1	1%	108
Gjilan	87	81%	12	11%	6	6%	2	2%	107
Hani i Elezit	80	82%	13	13%	5	5%	/	/	98
Kamenicë	79	84%	5	5%	8	9%	2	2%	94
Klinë	78	74%	16	15%	7	7%	4	4%	105
Drenas	74	77%	11	11%	8	8%	3	3%	96
Rahovec	74	71%	21	20%	4	4%	5	5%	104
Kaçanik	73	82%	4	4%	10	11%	2	2%	89
Skënderaj	71	88%	7	9%	3	4%	/	/	81
Obiliq	65	82%	6	8%	6	8%	2	3%	79
Fushë Kosovë	60	91%	3	5%	1	2%	2	3%	66
Graçanicë	53	82%	2	3%	6	9%	4	6%	65
Viti	47	75%	10	16%	4	6%	2	3%	63
Mitrovica e Veriut	43	51%	35	41%	2	2%	5	6%	85
Junik	36	90%	3	8%	1	3%	/	/	40
Deçan	32	84%	3	8%	2	5%	1	3%	38
Novobërdë	29	81%	5	14%	2	6%	/	/	36
Shtërpcë	29	83%	3	9%	3	9%	/	/	35
Leposaviq	28	74%	2	5%	/	/	8	21%	38
Zveçan	26	67%	6	15%	1	3%	6	15%	39
Mamushë	23	85%	4	15%	/	/	/	/	27
Klllokot	15	94%	1	6%	/	/	/	/	16
Ranillug	14	67%	5	24%	1	5%	1	5%	21
Zubin Potok	13	81%	1	6%		0%	2	13%	16
Partesh	6	100%	/	/	/	/	/	/	6
Gjithsej	3,088	83%	331	9%	182	5%	120	3%	3,721

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Shtojca 4. Vlera e kontratave të prokurimit publik në nivelin lokal, sipas organizatës buxhetore dhe gjinisë së pronarëve/eve

Komunitet	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	Vlera (€)
Komunat									
Prishtinë	31,883,739	93%	1,019,040	3%	1,390,765	4%	86,239	0%	34,379,785
Prizren	17,728,454	84%	122,775	1%	2,808,780	13%	520,584	2%	21,180,593
Ferizaj	10,348,468	82%	123,247	1%	1,317,917	10%	872,173	7%	12,661,805
Malishevë	10,027,099	92%	26,250	0%	803,973	7%	40,704	0%	10,898,026
Deçan	9,188,951	99%	22,966	0%	53,632	1%	1,204	0%	9,266,753
Rahovec	8,823,716	77%	2,293,619	20%	96,123	1%	298,806	3%	11,512,264
Podujevë	8,672,171	83%	167,599	2%	1,558,847	15%	52,850	1%	10,451,467
Fushë Kosovë	7,031,295	96%	15,795	0%	69,740	1%	181,844	2%	7,298,467
Suharekë	6,886,748	90%	48,551	1%	287,053	4%	449,854	6%	7,672,207
Pejë	6,451,018	85%	291,164	4%	843,272	11%	3,769	0%	7,589,223
Lipjan	5,398,109	72%	720,088	10%	777,332	10%	598,907	8%	7,494,437
Gjakovë	5,001,400	82%	876,090	14%	20,476	0%	185,477	3%	6,083,445
Obiliq	4,689,868	28%	47,641	0%	1,966,875	72%	4,491	0%	6,708,875
Skënderaj	4,554,953	89%	27,176	1%	515,132	10%	/	/	5,097,211
Istog	4,465,546	92%	172,544	4%	176,112	4%	21,838	0%	4,836,041
Dragash	4,289,767	91%	186,068	4%	176,639	4%	45,371	1%	4,697,845
Drenas	3,946,190	72%	198,362	4%	1,151,146	21%	221,341	4%	5,517,039
Viti	3,834,371	49%	2,950,830	38%	910,925	12%	74,821	1%	7,770,947
Vushtrri	3,473,534	88%	258,997	7%	198,864	5%	38,214	1%	3,969,609
Kamenicë	3,056,855	69%	63,718	1%	1,305,098	29%	3,067	0%	4,428,739
Shtime	3,029,291	81%	118,591	3%	577,670	15%	7,723	0%	3,733,275
Kaçanik	2,907,290	71%	288,658	7%	900,842	22%	6,894	0%	4,103,684
Klinë	2,302,884	70%	397,690	12%	377,683	11%	218,733	7%	3,296,991
Mitrovicë e Jugut	2,281,792	54%	11,101	0%	1,937,418	46%	/	/	4,230,311
Gjilan	2,046,818	61%	1,006,914	30%	284,323	8%	8,528	0%	3,346,583
Graçanicë	2,004,616	92%	13,908	1%	87,753	4%	64,472	3%	2,170,749
Mitrovica e Veriut	1,968,389	71%	182,424	7%	2,106	0%	617,364	22%	2,770,283
Hani i Elezit	1,235,542	92%	80,551	6%	19,635	1%	/	/	1,335,728
Leposaviq	1,211,055	61%	6,862	0%	/	/	769,026	39%	1,986,943
Shtërpcë	964,267	90%	88,105	8%	22,075	2%	/	/	1,074,447
Mamushë	536,731	91%	50,657	9%	/	/	/	/	587,388
Zubin Potok	479,015	74%	960	0%	/	/	165,165	26%	645,140
Novobërdë	443,197	64%	183,412	26%	70,970	10%	/	/	697,579
Junik	325,826	92%	18,286	5%	10,284	3%	/	/	354,398
Zveçan	284,906	59%	12,327	3%	5,368	1%	176,981	37%	479,582
Kllokot	281,409	99%	954	1	/	/	/	/	282,363
Ranillug	150,473	64%	15,482	7%	56,790	24%	12,742	5%	235,487
Partesh	5,895	100%	/	/	/	/	/	/	5,895
Gjithsej	182,211,651	79%	12,109,404	5%	30,781,620	13%	5,749,184	2%	230,851,859

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Shtojca 5. Numri i përfituesve/eve të prokurimit publik në institucionet e pavarura, sipas gjinisë

	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
	Numri	%	Numri	%	Numri	%	Numri	%	
Agjencia Kosovare e Privatizimit	13	62%	4	19%	4	19%			21
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	34	68%	10	20%	5	10%	1	2%	50
Zyra Kombëtare e Auditimit	29	88%	2	6%	1	3%	1	3%	33
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	29	78%	3	8%	2	5%	3	8%	37
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	27	93%		0%	1	3%	1	3%	29
Këshilli Prokurorial i Kosovës	27	79%	3	9%	2	6%	2	6%	34
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	26	76%	3	9%	4	12%	1	3%	34
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	23	85%	3	11%	1	4%			27
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	18	69%	3	12%	5	19%			26
Institucioni i Avokatit të Popullit	17	89%	1	5%	1	5%			19
Adakemia e Shkencave dhe Arteve	17	81%	1	5%	2	10%	1	5%	21
Gjykata Kushtetuese	15	94%		0%	1	6%			16
Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë	3	60%		0%	2	40%			5
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa	3	100%		0%		0%			3
Gjithsej	281	79%	33	9%	31	9%	10	3%	355

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Shtojca 6. Vlera e kontratave të prokurimit publik në institucionet e pavarura, sipas gjinisë

	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	Vlera (€)	%	
Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	3,360,740	80%	380,728	9%	466,311	11%	1,564	0%	4,209,343
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1,344,725	62%	696,241	32%	85,962	4%	32,450	2%	2,159,378
Radio Televizioni i Kosovës	742,601	90%	12,816	2%	33,183	4%	39,000	5%	827,600
Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror	640,564	88%	10,944	1%	15,585	2%	62,835	9%	729,928
Këshilli Prokurorial i Kosovës	523,496	92%	24,378	4%	8,862	2%	9,676	2%	566,412
Gjykata Kushtetuese	273,835	96%	/	/	12,187	4%	/	/	286,022
Zyra Kombëtare e Auditimit	242,230	92%	5,312	2%	897	0%	13,901	5%	262,340
Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale	205,955	94%	11,125	5%	990	0%	/	/	218,070
Komisioni Qendor i Zgjedhjeve	115,652	96%	/	/	950	1%	3,940	3%	120,542
Agjencia Kosovare e Privatizimit	108,312	48%	106,252	46%	13,006	6%	/	/	227,570
Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	72,830	78%	7,173	8%	12,923	14%	/	/	92,926
Institucioni i Avokatit të Popullit	62,920	93%	3,686	5%	975	1%	/	/	67,581
Adakemia e Shkencave dhe Arteve	56,219	93%	985	2%	2,261	4%	850	1%	60,315
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës	18,727	100%	/	/	/	/	/	/	18,727
Fondi i Kosovës për Efiçencë të Energjisë	2874	74%	/	/	990	26%	/	/	3,864
Gjithsej	7,771,680	79%	1,259,640	13%	655,082	7%	164,216	2%	9,850,618

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Shtojca 7. Numri i përfituesve/eve të prokurimit publik në ndërmarrjet publike, sipas gjinisë

	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
	nr	%	nr	%	nr	%	nr	%	nr
Trepça -Ndërmarrje në Administrim të AKP	416	66%	211	33%	1	0%	6	1%	634
Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.	410	84%	37	8%	23	5%	20	4%	490
Trepça SH.A.	162	83%	17	9%	9	5%	7	4%	195
Telekomi i Kosovës Sh.A.	84	82%	12	12%	2	2%	4	4%	102
Radio Televizioni i Kosovës RTK	78	84%	9	10%	4	4%	2	2%	93
K. Regj. e Mbeturinave Ekoregjioni SH.A.	65	86%	1	1%	7	9%	3	4%	76
Komp. Rajon Ujësllësit "Hidromorava" SH.A.	64	91%	4	6%	1	1%	1	1%	70
KOSTT SH.A	63	85%	5	7%	4	5%	2	3%	74
Posta e Kosovës Sh.A	56	67%	11	13%	9	11%	7	8%	83
K. R. U. " Hidroregjioni Jugor " Sh.A.	52	85%	4	7%	2	3%	3	5%	61
Infrastruktura E Hekurudhave Të Kosovës- Infrakos Sh.A.	47	92%	1	2%	2	4%	1	2%	51
Kompania Ujësllësi Rajonal PRISHTINA SH.A.	46	92%		0%	1	2%	3	6%	50
K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A.	35	92%	3	8%					38
Kompania Rajonale e Ujësllësit GJAKOVA SH.A.	35	90%	3	8%			1	3%	39
Hortikultura Sh.A.	34	92%	1	3%	2	5%			37
Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A.	34	83%	3	7%	4	10%			41
KRU " Hidrodrini " SH.A.	30	97%	1	3%					31
Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" Sh.A.	29	76%	7	18%	2	5%			38
Ndërmarrja Hidroekonomike" Ibër Lepenc"SH.A.	28	82%	4	12%	1	3%	1	3%	34
Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A.	28	90%	2	6%	1	3%			31
K. Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A.	27	79%	5	15%			2	6%	34

	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
KRU "Bifurkacioni" Sh.A.	27	79%	5	15%			2	6%	34
K. Regjionale e Mbeturinave Ambienti SH.A.	26	76%	5	15%			2	6%	34
N.P.K. " Trafiku Urban " Sh.A.	23	88%	2	8%	1	4%			26
Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.	21	84%	1	4%	3	12%			25
K. Regjionale e Mbeturinave "Çabрати"SH.A.	20	83%	4	17%					24
N.P.L." Pallati i Rinisë " Sh.A.	19	68%	4	14%	5	18%			28
Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking SH.A.	19	86%	1	5%	2	9%			22
"Kompani.për Menaxhimin e Deponive në Kosovë "Sh.A	17	71%	6	25%	1	4%			24
Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qëndrore Sh.A.	16	76%	2	10%	3	14%			21
K.R.U. Mitrovica SH.A.	15	71%	2	10%	3	14%	1	5%	21
Stacioni i Autobusëve Sh.A.	14	88%	2	13%					16
Ngrohtorja e Qytetit Gjakova Sh.A.	12	86%	2	14%					14
K. Regj. e Mbeturinave " Pastërtia " SH.A.	11	92%					1	8%	12
N.P.L Pastrimi Sh.A	9	75%	2	17%	1	8%			12
N.P.L Stacioni i Autobusëve - Gjakovë Sh.A	9	100%		0%					9
N.P.L. "Ambienti" Sh.A.	8	89%	1	11%					9
Higjiena Sh.A.	7	88%	1	13%					8
Sportmarketing Sh.A.	2	100%							2
KRU " Drini i Bardhë" Sh.A.	2	100%							2
Qendra Multifunkionale Sh.A	2	67%	1	33%					3
Gjithsej	2,102	79%	382	14%	94	4%	69	3%	2,647

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Shtojca 8. Vlera e kontratave të prokurimit publik në ndërmarrjet publike, sipas gjinisë

	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A	Gjithsej	
	Vlera (€)		Vlera (€)		Vlera (€)		Vlera (€)		Vlera (€)
Korporata Energjetike e Kosovës sh.a.	39,611,256	87%	2,978,275	7%	2,229,613	5%	739,311	2%	45,558,455
Telekomi i Kosovës Sh.A.	4,262,618	29%	122,074	1%	25,472	0%	10,212,339	70%	14,622,504
Trepça -Ndërmarrje në Administrim të AKP	6,926,888	86%	611,535	8%	19,200	0.24%	461,469	6%	8,019,092
Kompania Ujësjiellësi Rajonal PRISHTINA SH.A.	4,892,376	95%			98,712	2%	152,439	3%	5,143,527
Trepça SH.A.	2,759,197	61%	1,258,111	28%	218,995	5%	258,806	6%	4,495,109
K. Regj. e Mbeturinave Ekoregjioni SH.A.	1,949,086	96%	930	0.05%	84,617	4%	2,733	0.10%	2,037,366
KRU " Hidrodrini " SH.A.	1,245,292	98%	29,361	2%					1,274,653
Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A.	1,231,787	89%	10,661	1%	138,399	10%			1,380,847
Ngrohtorja e Qytetit Gjakova Sh.A.	1,105,909	99.90%	1,588	0.10%					1,107,497
K. R. U. " Hidroregjioni Jugor " Sh.A.	1,074,481	85%	12,312	1%	50,337	4%	122,863	10%	1,259,993
Radio Televizioni i Kosovës RTK	742,601	90%	12,816	2%	33,183	4%	39,000	5%	827,600
Kompania Rajonale e Ujësjiellësit GJAKOVA SH.A.	674,041	98%	11,858	2%			974	0.10%	686,873
Posta e Kosovës Sh.A	619,239	78%	65,083	8%	86,805	11%	24,160	3%	795,287
"Kompani.për Menaxhimin e Deponive në Kosovë "Sh.A	613,703	72.60%	230,604	27%	765	0.10%			845,072
KOSTT SH.A	568,543	54%	69,526	7%	400,490	38%	9,284	1%	1,047,843
K.Regjionale e Mbeturinave" Pastrimi " SH.A.	505,374	86%	81,354	14%					586,728
Ndërmarrja Hidroekonomike" Ibër Lepenc"SH.A.	450,546	89%	24,499	5%	12,090	2%	19,869	4%	507,004
K. Regjionale e Mbeturinave Ambienti SH.A.	432,875	98%	9,225	2%			1,750	0.40%	443,850
K. Regjionale e Mbeturinave "Uniteti" SH.A.	432,875	98%	9,225	2%			1,750	0.40%	443,850
Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A.	391,100	76%	12,566	2%	111,251	21.61%			514,917

	Burra		Gra		Burra dhe Gra		N/A		Gjithsej
Komp. Rajon Ujësjiellësit "Hidromorava" SH.A.	358,833	97%	7,360	2%	982	0.30%	900	0.20%	368,075
Infrastruktura E Hekurudhave Të Kosovës- Infrakos Sh.A.	306,289	98%	289	0%	3,762	1%	789	0.30%	311,129
N.P.K. " Trafiku Urban " Sh.A.	269,070	80%	55,208	16%	13,500	4%			337,778
KRU "Bifurkacioni" Sh.A.	233,615	83%	43,819	16%			4,770	2%	282,204
Operimi me Trena i Hekurudhave të Kosovës "Trainkos" Sh.A.	232,928	94%	14,158	6%	1,704	0.70%			248,790
K. Regjionale e Mbeturinave "Çabrati"SH.A.	218,571	95%	10,691	5%					229,262
Ndërmarrja Publike Lokale Kuzhina Qëndrore Sh.A.	217,072	89%	1,318	1%	26,628	11%			245,018
K.R.U. Mitrovica SH.A.	192,209	90%	2,687	1%	12,608	6%	6,513	3%	214,017
Ndërmarrje Publike Lokale Përparimi SH.A.	170,671	98%	708	0%	2,994	2%			174,373
Higjiena Sh.A.	165,458	99.80%	316	0.20%					165,774
Hortikultura Sh.A.	83,237	60%	2,257	2%	54,186	39%			139,680
N.P.L." Pallati i Rinisë " Sh.A.	82,947	33%	5,550	2%	164,426	65%			252,923
Stacioni i Autobusëve Sh.A.	55,235	93%	4,139	7%					59,374
K. Regj. e Mbeturinave " Pastërtia " SH.A.	51,718	92%					4,454	8%	56,172
Ndërmarrja Publike Lokale Prishtina Parking SH.A.	49,391	94%	1,388	3%	1,730	3%			52,509
Sportmarketing Sh.A.	18,530								18,530
N.P.L Pastrimi Sh.A	16,266	85%	1,974	10%	968	5%			19,208
N.P.L. "Ambienti" Sh.A.	15,681	96%	680	4%					16,361
N.P.L Stacioni i Autobusëve - Gjakovë Sh.A	7,691	100%							7,691
Qendra Multifunkionale Sh.A	5,333	89%	649	11%					5,982
KRU " Drini i Bardhë" Sh.A.	3,951	100%							3,951
Gjithsej	73,244,483	77%	15,895,573	17%	3,793,417	4.00%	1,873,395	2%	94,806,868

Burimi: GAP bazuar në të dhënat e KRPP

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

Instituti GAP mbështetet nga:



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World

Ky projekt është mbështetur nga



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo



Sweden
Sverige

